

VENDIM
Nr. 163, datë 15.5.2023

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN PRILL 2023, PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.5.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1350/1 prot., datë 8.5.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 2993 prot., datë 28.4.2023, protokolluar me tonën me nr. 1350 prot., datë 2.5.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a. ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, për muajin prill 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Referuar kërkesës së sipërcituar të FSHU sh.a. evidentohet se shoqëria vijon të përfshijë koston e disbalancave në përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ndërkohë që ERE në mënyrë të përsëritur, me shkresën nr. 2030/1 prot., datë 14.12.2022, ka sqaruar FSHU sh.a. se:

“... Në kuptim të nenit 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201, të Bordit të ERE-s datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë, për periudhën e lëvrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga rregullatori. Sikurse përcaktuar në metodologji, kostot e imbalancave (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca) do të llogariten dhe faturohen, në përputhje me përcaktimet e rregullave të tregut dhe akteve të tjera në fuqi.”, duke kërkuar ndaj shoqërisë që të marrë në konsideratë vetëm komponentët e njohur dhe të përfshirë në formulën e përcaktuar në metodologji.

- Mbështetur në nenin 8, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2023, janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit të përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijnë të jetë 1.55 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2023, përlllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin prill 2023			
		Njësia	Çmimi
CBEt	çmimi i blerjes së energjisë elektrike	Leke /kWh	13.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke /kWh	0.39
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke /kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke /kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke /kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke /kWh	16.85

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, do të jetë 16.85 lekë/kWh për muajin prill 2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin prill 2023, prej 16.85 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti